




REPUBLIKA E SHQIPËRISE

KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI BASENIT UJMBLEDHËS SEMAN



VENDIM

Nr. 7, datë 12.03.2021

PËR

MIRATIMIN E KËRKESËS PËR AUTORIZIM PËR PËRDORIMIN E BURIMIT UJOR PËR VEPRIMTARI NDËRTIMORE NË BRIGJE TË BASHKISË BERAT, ME VENDNDODHJE NJËSIA ADMINISTRATIVE BERAT, BASHKIA BERAT, QARKU BERAT

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.550, datë 15.07.2020, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli Basenit Ujor Seman.

VENDOSI:

1. Miratimin e kërkesës për autorizim të **Bashkisë Berat**, “Për përdorimin e burimit ujor” me objekt “Restaurimi i peizazhit historik urban të lagjes Goricë, rehabilitimi i shtegut të Kalasë së Goricës, krijimi i një parkimi makinash prane urës së vjetër të Goricës” me vendndodhje Njësia Administrative Berat, Bashkia Berat, Qarku Berat.
2. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KBU SEMAN

BAKI BALA

